



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

**ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE**

Nr. i Dokumentit: 22.19.1-2016-08

**RAPORTI I AUDITIMIT
PËR RAPORTIN FINANCIAR VJETOR TË KOMUNËS SË
KAÇANIKUT PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR
2016**

Prishtinë, qershor 2017

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikën e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të komunës së Kaçanikut, në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm Qerkin Morina, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nga Florim Maliqi – udhëheqës ekipi, Mexhit Ferati, dhe Arben Hundozi, anëtar, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të auditimit Fatlinda Ramosaj.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	7
2 Qeverisja.....	11
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	17
Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit	31
Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA.....	32
Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak	35
Shtojca IV: Letër konfirmimi	40

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Raportit Financiar Vjetor të Komunës së Kaçanikut për vitin 2016, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2016 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit¹, të datës 09.11.2016.

Auditimi ynë është fokusuar në:



(Më hollësisht, shih Shtojcën 1).

Niveli i punës së kryer nga Zyra Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2016 pasqyron drejtpërdrejt cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Komunës.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar me Theksim të Çështjes

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Theksimi i çështjes

Si Theksim të Çështjes dëshirojmë të përmendim faktin se gjatë vitit 2016, ishin paguar dhe regjistruar si pasuri kapitale shuma prej 97,428€, të cilat në fakt janë subvencione dhe transfere.

Formulimi i plotë i opinionit është dhënë në hollësi në kapitullin 1.1 të këtij raporti.

¹ Termi "Plani i Jashtëm i Auditimit" është zëvendësim i termit "Memorandumi i Planifikimi të Auditimit"


Shtojca I shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Dëshirojmë të falënderojmë Kryetarin e Komunës dhe stafin e tij për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore

Menaxhmenti i komunës ka dizajnuar sistemin e kontrollit të brendshëm, por këto kontrolle nuk kishin funksionuar në disa fusha të rëndësishme të menaxhimit financiar. Këto duhet në vazhdimësi të monitorohen për t'u siguruar se janë duke funksionuar siç duhet. Në vazhdim po i paraqesim fushat në të cilat janë vërejtur mangësi.

Konkluzionet dhe rekomandimet tona kryesore janë:



Edhe pse niveli i realizimit të shpenzimeve për investime kapitale ishte 85% e buxhetit të rishikuar, ato ishin mbivlerësuar me keqklasifikim të shpenzimeve.



Kryetari duhet të mbikqyrë në mënyrë sistematike buxhetin dhe të siguroj regjistrimin e tyre në kode adekuate (shih çështjen 7 dhe pjesën 1.1 Opinioni).

Edhe pse në disa fusha kontrollet e brendshme janë efektive, ekzistojnë dobësi të mëdha në disa sisteme të rëndësishme financiare, duke përfshirë prokurimin.



Kryetari duhet të sigurojë se do të zbatohen rregullat e prokurimit pasi në disa raste nuk ishin respektuar kriteret e dosjes së tenderit lidhur me sigurimin e ekzekutimit prej 10% nga vlera e kontratës.
(shih çështjet 17 deri 21).

Përgjigja e Kryetarit të Komunës

Kryetari i Komunës ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna. Më tutje Kryetari i Komunës është zotuar që:

- ta shqyrtoj Raportin e auditimit në Asamblenë Komunale; dhe
- deri në fund të muajit janar 2018, ta diskutoj në Asamblenë Komunale progresin lidhur me zbatimin e Planit të Veprimit për rekomandimet e auditimit, para se PFV 2017 të jenë dorëzuar në Ministrinë e Financave.

Për më tepër shih shtojcën IV.

1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

1.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i Pamodifikuar me Theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV-të e Komunës së Kaçanikut për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren e MF nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar të Organizatave Buxhetore.

Baza për opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se komuna kishte bërë keq klasifikim të shpenzimeve ku nga kategoria e investimeve kapitale kishte bërë pagesa 97,428€, në emër të bashkëfinancimit me OJQ "Caritas Kosova Luxemburg". Bashkëfinancimi me këtë donator ishte bërë në emër të projektit "Zhvillim i i komuniteteve" si dhe në projektin "Zhvendosja e personelit mjekesorë" në një objekt

të marrë me qira për shkak të ndërtimit të objektit të ri të QKMF-së në Kaçanik. Shpenzimet e ndodhura ishin aprovuar me tabelat buxhetore të Buxhetit 2016 si investime kapitale, por projektet e paraqitura në tabela, nuk përmbushin kushtet që të trajtohen si projekte kapitale. Gabimet kanë të bëjnë me planifikimet fillestare nga komuna dhe aprovimet jo adekuate nga ana e MF. Përveç kësaj, vlera e pasurive të regjistruara në regjistrin e pasurive dhe të prezantuara në PFV ishin mbivlerësuar për shumat e lartcekura.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave përgjegjës për qeverisje dhe PFV

Kryetari i komunës së Kaçanikut është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Kryetari i Komunës dhe Zyrtari Kryesor Financiar janë përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të komunës.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq deklarim material që ekziston. Keq deklarimet mund të rrjedhin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

1.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Nga komuna kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 01/2013;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK);
- Nëse PFV janë përgatitur brenda kornizës kohore dhe janë dorëzuar ne MF;
- Nëse Draft plani dhe plani përfundimtar i prokurimit është dorëzuar me kohë; dhe
- Nëse Komuna kishte përgatitur dhe dorëzuar raporte të rregullta tremujore tek Kuvendi Komunal dhe një kopje tek MF.

Të gjitha kërkesat e lartshënuara janë përmbushur, por në draft Pasqyrat Financiare Vjetore janë vërejtur disa mangësi. Ne kemi dhënë disa sugjerime për të përmirësuar të dhënat në PFV dhe për të siguruar plotësinë e shpalosjeve të nevojshme. Disa korrigjime financiare të bëra janë si në vijim:

- Tek neni 13 Pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, totali i shfrytëzimit të fondeve është paraqitur gabimisht në vlerë 1,219€, ndërsa është dashur të jetë totali shpenzimeve në vlerë 6,651€. I njëjti gabim është përsëritur edhe në të dhënat e viteve paraprake;
 - Neni 14 Raporti i ekzekutimit të buxhetit, në kolonën e buxhetit fillestar tek dalja e parasë së gatshme për mallra dhe shërbime dhe shpenzime komunale janë prezantuar vlerat e buxhetit të rishikuar;
 - Tek shpalosjet e shënimit 3 në kategorinë mallra dhe shërbime ka dallime në mes asaj çka është shpenzuar sipas SIMFK dhe asaj që është shpalosur në PVF mes kodeve ekonomike si në vijim:
 - Kodi ekonomik 13470 (shërbime teknike) sipas thesarit vlera është 5,456€ kurse në shpalosje 5,507€;
 - Kodi ekonomik 13503 (Kompjuter në vlerë nën 1000€) sipas thesarit vlera është 4,296€ kurse në shpalosje 3,996€;
 - Kodi ekonomik 13504 (Harduer për TI në vlerë nën 1000€) sipas thesarit vlera është 1,078€ kurse në shpalosje 0€;
-

- Kodi ekonomik 13917 (Provizion Bankar NLB) sipas thesarit vlere është 196€ kurse në shpalosje 2,996€;
- Kodet ekonomike nga 14010 deri te kodi 14060 (Mirëmbajtja) sipas thesarit vlere është 126,795€, kurse në shpalosje 122,257€;
- Kodet ekonomike 14210, 14220 dhe 14230 (Publikime dhe reklama) sipas thesarit vlere është 6,019€, kurse në shpalosje 6,219€; dhe
- Shpenzimet tjera për shërbime nuk figurojnë në thesar, por në shpalosje është prezantuar si zë i veçantë në shumë prej 2,866€.
- Tek shpalosjet e shënimi 3 mallra dhe shërbime dhe shënimi 6 investime kapitale janë paraqitur gabimisht vlerat tek të hyrat e dedikuara ndërsa është dashur të paraqiten tek grantet e përcaktuara të donatorëve;
- Tek shënimet shpjeguese 2, 3, 4, 5 dhe 6 të kolona e Buxhetit Final, mungon shpalosja nëpër kode ekonomike dhe totali në këtë kolonë;
- Tek shpalosjet e shënimit 12, gabimisht janë përfshirë edhe donacionet e vitit të kaluar në vlerë 2,377€.

Korrigjimet më sipër janë bërë në versionin final të PFV-ve finale, por përmbledhja e pasurive jo financiare mbi 1,000€ nuk ishte paraqitur e saktë. Këtë çështje më gjerësisht e kemi trajtuar tek nënkapitulli 1.1 Opinioni auditimit.

DEKLARATA E BËRË NGA MENAXHMENTI I KOMUNËS

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të draft PFV-ve në Ministrinë e Financave, mund të konsiderohet e saktë, përveç çështjes së theksuar te opinioni, por që nuk konsiderohet me ndikim material.

1.3 Rekomandimet për pjesën e parë të raportit

Për çështjet e sipër përmendura jepet rekomandimi

Rekomandimi 1 Kryetari duhet të sigurojë se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes së Opinioni dhe të merren veprimet e duhura për t'i evituar gabimet në keq klasifikimin e shpenzimeve dhe mos regjistrimin e saktë të pasurive. Gjithashtu, duhet të sigurojë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2017 i adreson të gjitha çështjet e ngritura në raport dhe Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të dorëzohet përveç nëse ndaj draft PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.

2 Qeverisja

Hyrje

Aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për menaxhmentin e komunës që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit, pasi kjo tregon se menaxhmenti është duke i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollat. Në mënyrë të ngjashme, lista kontrolluese e vet-vlerësimit që plotësohet nga OB-të siguron një kornizë për zhvillimin e aranzhimeve të zgjeruara të qeverisjes. Është e rëndësishme që përgjigjet e dhëna nga një OB të jenë të mbështetura me dëshmitë përkatëse.

Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes pasqyron një shqyrtim të:

- fushave të aranzhimeve të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku besojmë se rekomandimet tona mund të gjenerojnë përmirësime pozitive, duke e përfshirë edhe shqyrtimin e sistemit të Auditimit të Brendshëm; dhe
- fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të identifikuar përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të të hyrave dhe shpenzimeve (këto fusha janë shqyrtuar në kapitullin 3 të këtij Raporti).

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ekziston një numër i dobësive të qeverisjes brenda komunës veçanërisht në lidhje me llogaridhënien, menaxhimin e rrezikut dhe cilësinë e raportimit menaxherial. Lista kontrolluese e vet-vlerësimit, e plotësuar nga komuna, e pasqyron këtë situatë vetëm pjesërisht, duke iu përgjigjur shumicës së pyetjeve me notë mesatare prej 2.27. Sipas listës së vet-vlerësimit komuna kishte dhënë përgjigje negative në 28 pyetje. Kjo do të thotë se menaxhmenti duhet të marrë parasysh çështjet të cilat nuk kanë arritur nivelin e pritur.

Një ndër elementet kyçe të një qeverisje efektive të komunës është edhe zbatimi i rekomandimeve të dhëna nga auditimi i jashtëm. Auditimi i këtij viti ka nxjerrë në pah se niveli i rekomandimeve të zbatuara nga viti i kaluar ishte i ulët, dhe vetëm 5 nga 18 rekomandime ishin zbatuar.

Komuna ka planin zhvillimor nga viti 2011, por ky plan nuk përfshinë llogaritjen e kostove për matjen e rezultateve të objektivave të saj. Plani zhvillimor i komunës me shumë prezanton statistika se sa trendin e zhvillimit të vet komunës.

Përveç një plani emergjent, komuna nuk kishte përgatitur një listë të rreziqeve të cilat janë kërkesë e procedurave të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Raporti jonë i auditimit për PFV-të 2015 ka rezultuar me 18 rekomandime. Komuna e Kaçanikut ka përgatitur dhe dorëzuar me kohë Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve nga viti paraprak. Raporti ynë ishte diskutuar edhe në Kuvendin Komunal. Deri në përfundim të auditimit 2016, pese (5) rekomandime ishin zbatuar, shtatë (7) ishin në proces të zbatimit dhe gjashtë (6) nuk ishin zbatuar. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shih Shtojcën III.

Çështja 2 - Zbatimi i rekomandimeve nga viti paraprak - Prioriteti i lartë

E gjetura Vetëm një pjesë e rekomandimeve të vitit të kaluar janë zbatuar sepse menaxhmenti nuk ka ndjekur ndonjë proces formal për të menaxhuar dhe monitoruar mënyrën e zbatimit të rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm.

Rreziku Dobësitë e vazhdueshme të kontrolleve të menaxhmentit dhe kontrolleve tjera në sistemet financiarë kyçe kanë rezultuar në:

- Përsëritje të keq klasifikimit të shpenzimeve kapitale;
- Dobësive lidhur me të arkëtueshmet nga qiraja;
- Dobësi në hartimin e listës së rreziqeve;
- Dobësi të vazhdueshme në shpenzimet përmes prokurimit dhe vlerë të dobët për paranë; dhe
- Përfitim të limituar nga puna e Auditimit të Brendshëm.

Rekomandimi 2 Kryetari duhet të sigurojë se do të zbatohet një proces i forcuar i llogaridhënies së stafit përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve, sipas afateve kohore dhe prioriteteve të përcaktuara me planin e veprimit. Monitorimi i progresit të rekomandimeve duhet të bëhet në mënyrë sistematike.

2.2 Pyetëtori i vet-vlerësimit të komponentave të MFK-së

Ministria e Financave ka hartuar një listë të detajuar të vetvlerësimit për organizatat buxhetore për të mbështetur aranzhimet efektive të qeverisjes. Për të gjitha auditimet e ndërmarra, ne kemi testuar cilësinë e pyetësorëve të vet-vlerësimit të MFK-së të dorëzuara në Ministri, duke vlerësuar nga një pyetje kyçe në secilën komponentë të listës kontrolluese. Ne kemi përmbledhur më poshtë të gjeturat tona për komunën, të cilat nuk kanë për qëllim të ofrojnë komente për cilësinë e tërë pyetësorit të dorëzuar të vet-vlerësimit, por pasqyrojnë gjendjen për një numër të pyetjeve kyçe për të mbështetur përpjekjet e Ministrisë së Financave në rritjen e efektivitetit të procesit dhe në zhvillimin e sistemit të MFK-së në tërësi.

Çështja 3 – Pyetëtori i vet-vlerësimit – Prioritet i lartë

E gjetura Si pjesë e auditimit tonë, i kemi shqyrtuar çështjet kyçe të pyetësorit të vetvlerësimit në lidhje me pesë komponentët. Për pyetjet e shqyrtuara kemi gjetur se:

1. Pyetëtori i vetvlerësimit i plotësuar nga stafi komunal ka dëshmuar se komuna ende nuk ka hartuar listën e rreziqeve të cilat mund të ndodhin dhe të cilat mund të ndikojnë në arritjen e objektivave;
2. Proceset efektive të monitorimit si dhe mungesa e strategjisë gjithëpërfshirëse të zhvillimit (përfshirë ndërlidhjen me palët e interesit si dhe sigurimin e strategjisë me kosto të plotë) nuk janë të vendosura nga Komuna. Komuna gjatë vitit 2016 kishte raportuar në MF progresin fizik dhe financiar të projekteve sipas kërkesave të ligjit të buxhetit, po ashtu janë shqyrtuar më hollësisht në nënkapitullin 2.3.1;
3. Auditimi i Brendshëm nuk i ka theksuar çështjet më lart. Për më shumë, veprimi i ndërmarrë për adresimin e çështjeve të identifikuara nga vetvlerësimi i vitit 2016 është i limituar. Kjo situatë ka ndodhur për shkak të mungesës së qartësisë brenda komunës që ka të bëjë me rëndësinë e kësaj liste kontrolluese dhe me atë se kush është zyrtari përgjegjës që i përdorë këto mekanizma për t'i mbështetur përmirësimet operative.

Rreziku Mungesa e hartimit të listës së rreziqeve dhe mënyra e menaxhimit të tyre shpalosin dobësi në qeverisje, dhe si të tilla reduktojnë mundësinë e menaxhmentit për të reaguar me kohë ndaj rreziqeve të mundshme.

Rekomandimi 3 Kryetari duhet të sigurojë se është rishikuar plotësimi i listës kontrolluese të vetvlerësimit dhe është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë proaktive. Duhet të aplikohet një mekanizëm për ta konfirmuar saktësinë e listës kontrolluese si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës. Ne do të sugjerim që lista kontrolluese të mos i dorëzohet MF-së para se të rishikohet nga auditimi i brendshëm.

2.3 Rishikimet specifike të qeverisjes

Puna jonë në fusha të veçanta të aranzhimeve të qeverisjes është bazuar përmes planifikimit të auditimit, duke marrë parasysh kontekstin brenda të cilit komuna operon dhe sfidat me të cilat përballet.

2.3.1 Përcaktimi i objektivave strategjike

Komuna është e obliguar të përgatisë dhe të përcjellë planet strategjike në nivel të organizatës, si: planet urbanistike, hapësinore, plani operativ emergjent, plani strategjik kundër korrupsionit, strategjia e zhvillimit rajonal etj.

Komuna ka hartuar një sërë dokumentesh strategjike, si: Plani urbanistik; Planin zhvillimor komunal dhe planin strategjik zhvillimor 2017-2019.

Çështja 4 - Planet strategjike - Prioritet i lartë

Komuna ka një plan të përgjithshëm të zhvillimit, por nuk ka qartësuar përgjegjësitë për koordinimin dhe zhvillimin e tij, si dhe mungon llogaritja e kostove të planit zhvillimor. Komuna ka një plan të hartuar kundër korrupsionit, por kërkesat nga ky plan ende nuk kanë filluar të adresohen.

Rreziku Paqartësia mbi zbatimin e planit zhvillimor, bën të pamundur të përcillet përmbushja e objektivave në pikëpamje të vizionit të Komunës, si një ndër kushtet esenciale të qeverisjes së mirë.

Rekomandimi 4 Kryetari duhet hartoj planin e veprimit për monitorimin e arritjes së objektivave duke vendosur funksione efektive të mbikëqyrjes. Të siguroj se do te përgatitet edhe plani kundër korrupsionit i cili do të zbatohet sipas kërkesave, dhe si i tillë do të bëhet funksional për një qeverisje më efektive.

2.3.2 Raportimi menaxherial dhe llogaridhënia

Menaxhmenti ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara. Lidhjet në mes të planit të prokurimit dhe buxhetit si dhe përpilimi i raporteve adekuata në baza të rregullta kohore konsiderohen si të vendosura nga komuna dhe dëshmitë që na janë dhënë e mbështesin deri diku këtë konkluzion, edhe pse raportet nuk janë përpiluar gjithmonë në baza të rregullta kohore.

Çështja 5 - Dobësi në kontrollet menaxheriale - Prioriteti i lartë

- E gjetura** Rishikimi ynë i kontrolleve menaxheriale të zbatuara në sistemin kryesor financiar të komunës ka nxjerrë në pah një raportim të dobët financiar mbi shpenzimet, të hyrat, të arkëtueshmet dhe të pagueshmet, tek menaxhmenti i lartë, si dhe analiza të pakompletuara të ofrimit të shërbimeve. Kjo ka ndodhur për shkak se formati i raporteve menaxheriale nuk ofron shpjegime rreth variancave në buxhet dhe se parashikimet buxhetore nuk janë azhurnuar në baza mujore. Ngjashëm, synimet operationale nuk menaxhohen në mënyrë sistematike.
- Rreziku** Kualiteti i raportimit financiar dhe aktiviteteve tek menaxhmenti i lartë, ka reduktuar aftësinë e menaxhmentit për të menaxhuar aktivitetet e komunës në mënyrë pro aktive si dhe ka ulur efektin e kontrolleve buxhetore. Kjo mund të rezultojë në deficit ose suficit të paplanifikuar dhe të vonoj veprimet e nevojshme për t'i adresuar ato. Kjo, gjithashtu, mund të ndikoj që të hyrat të mos arkëtohen në nivelin e pritur.
- Rekomandimi 5** Kryetari duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të sigurojë se është vendosur një zgjidhje e përshtatshme deri në fund të vitit 2017.

2.4 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me një auditore e cila është edhe drejtor i NJAB. Ndikimi i produkteve të Auditimit të Brendshëm duhet të gjykohet nga rëndësia që i jep menaxhmenti adresimit të rekomandimeve si dhe nga mbështetja sistematike e një Komiteti efektiv të Auditimit.

Çështja 6 - NJAB dhe komiteti i auditimit - Prioriteti i lartë

E gjetura Sipas planit strategjik për auditim të brendshëm për vitin 2016 janë planifikuar të realizohen gjithsej 10 auditime, ndërsa në planin vjetor 2016 janë përfshirë gjashtë (6) auditime, të cilat janë realizuar brenda vitit. Tre (3) nga këto auditime janë vlerësuar me rrezik të lartë, dy (2) me rrezik të mesëm dhe një (1) me rrezik të ulët. Mos përmbushja e aktiviteteve audituese në harmoni me planin strategjik ka rezultuar nga mungesa e kapaciteteve njerëzore në NJAB.

Zbatimi i rekomandimeve të dhëna në raportet finale të aktiviteteve të përfunduara të auditimit të NJAB pritet të bëhet nga drejtuesit e njësive përgjegjëse të audituara, por që të njëjtat plane nuk ishin përgatitur.

Rreziku Mungesa e kapaciteteve të mjaftueshme njerëzore në NJAB ka rezultuar me mos përmbushje të aktiviteteve të planifikuara të auditimit sipas planit strategjik, dhe rrjedhimisht me mos përfshirje të aktiviteteve audituese sipas vlerësimit të rrezikut dhe në proporcion me madhësinë e organizatës. Ndërsa mos përgatitja e planeve të veprimit nga menaxhmenti përkatës i audituar për implementimin e rekomandimeve të dhëna NJAB, mund të ndikon në nivelin e zbatimit të rekomandimeve përkatësisht në mos përmirësimin e gjendjes së evidentuar dhe në përmbushjen e objektivave të organizatës.

Rekomandimi 6 Kryetari duhet të siguroj ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme për respektimin e udhëzimeve ligjore, lidhur me organizimin e përbërjes së strukturës organizative të NJAB, respektivisht fuqizimin e rolit të shërbimeve të auditimit të brendshëm. Gjithashtu, të siguroj zbatimin e rekomandimeve të NJAB nga drejtoritë përgjegjëse të sistemeve të audituara, si dhe Komiteti i auditimit të hartoj raportin vjetor në harmoni me Udhëzimin Administrativ 11/2010.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) jashtë fushave të qeverisjes të përmendura në kapitullin 2, pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Si pjesë e kësaj, ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit dhe të burimeve njerëzore, si dhe pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Për komunën, prokurimi mbetet ndër sfidat kryesore, për shkak se rregulloret nuk janë aplikuar si duhet, dhe kjo ka rezultuar në vlerë të dobët për para. Numri i madh i aneks kontratave përshkruan më së miri dobësitë në planifikimin e prokurimit, pastaj mos respektimi i procedurave të prokurimit, pagesa pa dëshmi të mjaftueshme etj. Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi të hyrat, në përgjithësi, janë më të mira, por kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtejshëm për të parandaluar komunën që mos të pësoj dëme buxhetore. Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime janë pagesat në emër të bashkëfinancimeve, keq klasifikimi i shpenzimeve si dhe mbledhja e të arkëtueshmeve, sidomos nga qiraja dhe taksa në biznes.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar të hyrat e arkëtuara, burimet e fondeve buxhetore, si dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Të hyrat vetjake (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2016 Pranimet	2015 Pranimet	2014 Pranimet
Të hyrat vetjake	709,672	709,672	632,567	556,372	383,612

Në vitin 2016, plani i të hyrave ishte realizuar 89%, për dallim nga viti 2015 ku të hyrat ishin mbledhur 80%, ndërsa në vitin 2014 plani ishte realizuar 85%. Pra, në vitin 2016 realizimi i të hyrave vetjake ka shënuar një rritje krahasuar me vitin paraprak prej 9%. Të hyrat përfshirë edhe ato të bartura nga viti paraprak, ishin shpenzuar kryesisht për projekte kapitale në shumë 454,682€, për mallra dhe shërbime 74,153€, për subvencione dhe transfere 103,580€ dhe për paga dhe mëditje 1,667€.

Tabela 2. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ²	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
Burimet e Fondeve:	6,631,386	6,883,478	6,651,210	6,942,159	6,545,962
Granti i Qeverisë -Buxheti	5,921,714	6,016,076	6,004,938	6,363,848	6,040,636
Të bartura nga viti paraprak ³ -	0	142,982	139,523	143,851	119,390
Të hyrat vetjake ⁴	709,672	709,672	494,561	421,703	383,612
Donacionet e brendshme	0	6,948	6,788	9,040	0
Donacionet e jashtme	0	7,800	5,400	3,717	2,324

Buxheti final krahasuar me buxhetin fillestar ishte më i lartë për 252,092€. Ky ndryshim ka ardhur si rezultat i rritjes së Grantit Qeveritar prej 94,362€, të hyrave të bartura nga viti i kaluar 142,982€, të hyrave nga donacionet e brendshme dhe të jashtme 14,748€.

Realizimi i buxhetit në vitin 2016 ishte 6,651,210€ ose 97% nga buxheti final deri sa në vitin 2015 ishte shpenzuar 96% dhe në vitin 2014, 95%. Ne përgjithësi, komuna ka treguar një nivel të lartë të performancës buxhetore, përveç kategorisë së investimeve kapitale.

Tabela 3. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	6,631,386	6,883,478	6,651,210	6,942,159	6,545,962
Pagat dhe Mëditjet	4,730,156	4,826,026	4,811,836	4,711,887	4,315,980
Mallrat dhe Shërbimet	510,531	530,050	504,543	453,387	488,117
Shërbimet komunale	132,750	134,500	116,053	123,890	118,209
Subvencionet dhe Transferet	204,690	205,291	204,270	266,721	169,357
Investimet Kapitale	1,053,259	1,187,611	1,014,508	1,386,274	1,454,299

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë dhënë si në vijim:

- Buxheti për investime kapitale në vitin 2016 ishte rritur për 134,352€. Niveli i ekzekutimit të buxhetit final ishte 85%. Shpenzimet kapitale kanë shënuar një ulje për 371,766€ krahasuar me vitin 2015. Programi për Investime Publike përfshin disa projekte në vazhdim nga viti i kaluar (13) dhe projekte të reja (34) për vitin aktual. Prej 47 projekteve të planifikuara, 7 prej tyre nuk kishin filluar fare të realizohen;

² Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

³ Të hyrat vetjake të Komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

⁴ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e buxhetit të vet.

-
- Rritja e buxhetit për paga dhe mëditje për 95,870€, është rezultat i pagesave për përvojën e punës si dhe deficitit në paga në fund të vitit;
 - Rritja e buxhetit tek kategoria për mallra dhe shërbime në shumë 19,519€ si dhe shpenzimet komunale në shumë prej 1,750€ ishte bërë për shkak të obligimeve të mbetura nga vitit paraprak;
 - Buxheti për subvencione dhe transfere është rritur për 601€ për shkak të nevojave për ndihmë për entitetet jo publike. Pavarësisht kësaj, në fund të vitit 2016 kishte mbetur si obligime të pa paguara ndaj përfituesve individual shuma prej 14,145€; dhe
 - Donacionet e brendshme ishin 6,948€ si dhe ato të jashtme 7,800€. Donacionet e brendshme kryesisht ishin shfrytëzuar për investime kapitale, ndërsa donacionet e jashtme ishin shfrytëzuar kryesisht për mallra dhe shërbime.

Çështja 7 – Realizimi i buxhetit – Prioriteti i lartë

- E gjetura** Komuna ka treguar një efikasitet të lartë në realizimin e buxhetit pothuajse në të gjitha kategoritë e shpenzimeve. Mirëpo, një ngecje në krahasim me kategoritë tjera, vërehet për investime kapitale (85%). Kjo ka ndodhur për shkak të mungesës së planifikimit dhe kontrollit sistematik buxhetor të komunës në realizimin e projekteve kapitale sipas planit dinamik. Kjo u dëshmuar edhe nga 7 projektet e planifikuara, të cilat nuk kishin filluar fare në vitin 2016.
- Rreziku** Mosrealizimi i buxhetit sipas projeksioneve fillestare do të rezultojë në mos arritjen e objektivave të komunës dhe në financimin e projekteve dhe detyrimeve të vitit aktual nga buxheti i vitit të ardhshëm.
- Rekomandimi 7** Kryetari duhet të siguroj dhe të përcaktoj objektiva të qarta për përmirësimin e planifikimit dhe ekzekutimit të buxhetit në periudhat e ardhshme, dhe të vendosë një monitorim sistematik mbi ekzekutimin e buxhetit të planifikuar, sidomos për projektet kapitale.

3.1.1 Të hyrat

Të hyrat e gjithmbarshme në komunën e Kaçanikut për vitin 2016 ishin 632,567€. Prej tyre 557,286€ janë mbledhur nga komuna, ndërsa 75,281€ janë të hyra nga gjobat e trafikut, gjykatat dhe agjencia pyjore.

Komuna ka vendosur një gamë kontrollesh për inkasimin e të hyrave vetjake, por këto kontrolle duhet të forcohen dhe monitorohen në mënyrë sistematike për të dhënë rezultatet e pritura.

Çështja 8 - Dobësi në menaxhimin e tatimit në pronë - Prioritet i mesëm

- E gjetura** Komuna nuk kishte arritur të bëjë ri-anketimin për verifikimin 1/3 e pronave të regjistruara ashtu, siç kërkohet me udhëzimin administrativ 03/2011. Verifikimi ishte bërë vetëm për 709 nga 2900 prona të regjistruara apo mbi 24%.
- Rreziku** Verifikimi jo i plotë i pronave sipas kërkesave ligjore mundëson paraqitjen e gabimeve në kalkulimin e vlerës së tatimit dhe mund të rezultojë me ngarkesa të parregullta për qytetarë.
- Rekomandimi 8** Kryetari duhet të vendos kontrolle mbi verifikimin e pronave, ndryshimet të përcillen në kohë dhe ngarkesat për tatimpaguesit të jenë të sakta, me qëllim të realizimit korrekt të tatimit në pronë.

Çështja 9 - Vonesa për leje ndërtimi - Prioritet i lartë

- E gjetura** Sipas të dhënave të Thesarit të hyrat për leje ndërtimi për periudhën vitin 2016 ishin 11,206€ apo 56% me pak se vitin paraprak. Me rastin e rishikimi të evidencës për leje ndërtimi, kemi gjetur se prej 17 kërkesave, 5 prej tyre nuk ishin shqyrtuar në afat prej 30 ditë pas pranimit të kërkesës, por ishin ende në proces. Po ashtu, nuk ka një sistemim të dokumentacionit për të vërtetuar se dosja e rishikuar përmban të gjitha dokumentet e kërkuara.
- Rreziku** Fakti se ka pasur pak aprovime të kërkesave, pastaj vonesa në aprovimin e kërkesës për leje ndërtimi, mund të rrit rrezikun që qytetarët të mos aplikojnë për leje ndërtimi dhe në këtë rast komuna të këtë humbje financiare si rezultat i ndërtimeve pa leje, dhe të mos ketë kontrollet e duhura në fushën e ndërtimeve.
- Rekomandimi 9** Kryetari duhet të siguroj se shërbimi i urbanizmit do t'i shqyrtoj të gjitha kërkesat, vetëm pasi të njëjtat të jenë të kompletuara me të gjitha dokumentet përcjellëse të cilat kërkohen për një leje ndërtimi si dhe të siguroj se komisioni për shqyrtimin e kërkesave do të zbatoj afatin prej 30 ditësh nga pranimi i kërkesës, në mënyrë që shërbimet të jenë të shpejta dhe të sakta ndaj qytetarit.

Çështja 10 - Mos arkëtimi i qirasë nga pronat publike - Prioritet i lartë

E gjetura Të hyrat e planifikuara nga shfrytëzimi i pronës publike për vitin 2016 ishin 25,000€ deri sa ishin inkasuar 15,938€. Pavarësisht shkallës së inkasimit, me rastin e testimit tetë (8) rasteve kemi gjetur se komuna më 08.01.2016 ka vazhduar kontratën me qiramarrësit e pronës publike, edhe pse qiramarrësit nuk kishin kryer obligimet paraprake.

Zyrtari përgjegjës mbanë evidencë për të gjitha pronat e dhëna me qira, mirëpo kjo evidencë nuk ka informata të mjaftueshme për të siguruar se të gjitha vlerat janë të llogaritura saktë dhe drejtë. Kësaj evidence i mungonin informatat për saldon e bartur të borxhit nga viti paraprak si dhe informatat për datën e kontraktuar, përfshirë këtu edhe periudhën e shfrytëzimit të pronës komunale.

Rreziku Vazhdimi i kontratave ndaj qiramarrësve pa i kryer obligimet paraprake rritë rrezikun e inkasimit të qirave, si dhe mungesa e monitorimit ndaj shfrytëzuesve të hapësirave publike rritë rrezikun që komuna të ketë humbje financiare. Po ashtu, mos mbajtja e evidencës së qiramarrësve me informata të plota bën që menaxhmenti të mos ketë informata për vlefshmërinë e kontratave dhe mund të ndikoj në aplikimin e masave ndëshkuese për të gjithë ata të cilët nuk janë likuid ndaj obligimit si qiramarrës.

Rekomandimi 10 Kryetari duhet të sigurojë se nuk do bëhet vazhdimi i kontratave me qiramarrësit që nuk i kanë kryer obligimet paraprake, dhe të vendos masat e duhura që brenda një periudhë të arsyeshme të inkasoj të gjitha borxhet e prapambetura. Gjithashtu, të kërkoj nga zyrtari përgjegjës të krijoj një evidencë të qartë dhe të komplettoj atë me të gjitha informatat e nevojshme në mënyrë që menaxhimi i qirave të jetë më efikas.

3.1.2 Pagat dhe mëditjet

Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar. Kontrollat kyçe që e konfirmojnë saktësinë dhe plotësinë e pagesave janë: a) autorizimi i listës së pagave; b) verifikimi i ndryshimeve të mundshme dhe c) rishikimi buxhetit për këtë kategori si dhe barazimi me Thesarin. Shpenzimet për paga dhe mëditje për vitin 2016 ishin 4,811,836€ apo rreth 100% e buxhetit për këtë kategori.

Çështja 11 - Ekzekutimi i pagës pas skadimit të kontratës së punës - Prioritet i mesëm

E gjetura Në një rast kemi evidentuar se një i punësuar në departamentin e shërbimeve të shëndetësisë primare është paguar me pagë në muajin pasues pas skadimit të kontratës së punës, ndërsa marrëdhënia e punës i është ndërprerë me aktvendim pas pranimit të pagës, respektivisht në fillim të muajit të dytë pas skadimit të kontratës.

Rreziku Mos respektimi i afateve kohore të skadimit të kontratës së marrëdhënies së punës, respektivisht ekzekutimi i pagës pas përfundimit të kontratës së punës, mund të rezultoj me shpenzim të pa planifikuar të buxhetit.

Rekomandimi 11 Kryetari duhet të siguroj ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme për respektimin e procedurave për largimin me kohë nga sistemi i pagave të personave të cilëve u është ndërprerë marrëdhënia e punës.

Çështja 12 - Licencat e punës së personelit shëndetësor - Prioritet i mesëm

E gjetura Në dy raste kemi evidentuar se personeli shëndetësor në departamentin e shërbimeve të shëndetësisë primare, nuk i kanë licencat e punës të azhurnuara apo të ripërtëritura me afat kohor valid, të cilat shërbejnë për të ushtruar profesionin në mënyrë të pavarur dhe në harmoni me rregullat ligjore, përderisa aktualisht posedojnë licenca të punës me afat të skaduar.

Rreziku Mos përtëritja e licencave të punës apo ri licencimi i personelit shëndetësor, mund të rezultoj me mos harmonizim me Udhëzimin Administrativ (Shëndetësi), Nr. 10/2011 Regjistrimi dhe Licencimi i Profesionistëve Shëndetësor.

Rekomandimi 12 Kryetari duhet të sigurojë ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme për respektimin e kërkesave ligjore, lidhur me ri licencimin sipas nevojës të personelit shëndetësor, në pajtueshmëri me Udhëzimin Administrativ përkatës për regjistrimin dhe licencimin e profesionistëve shëndetësor.

3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2016 ishte 530,050€. Prej tyre ishin shpenzuar 504,543€ apo rreth 95% nga buxheti i ndarë për këtë kategori. Obligimet e papaguara për mallra dhe shërbime në fund të vitit 2016 ishin 3,708€.

Çështja 13 – Mangësi në zbatimin e kontratave dhe kryerjen e pagesave – Prioritet i Lartë

E gjetura Komuna kishte lidhur një kontratë me datën 02.02.2016 në shumë prej 53,810€ për mirëmbajtjen e rrugëve lokale. Më 17.03.2016 komuna kishte paguar OE “në shumë 13,130 për një faturë të datës 26.02.2016 në emër të situacionit të parë për mirëmbajtjen e rrugëve verore dhe dimërore. Ne nuk kemi gjetur se organi mbikëqyrës ka konfirmuar me shkrim rregullsinë e situacionit të parë. Sipas analizës kemi vërejtur se komuna brenda 6 muajve ka realizuar këtë projekt, edhe pse kishte lidhur kontratë një vjeçare. Kjo është si rezultat i mos planifikimit të duhur të shpenzimeve sepse komuna ka nevojë për tërë vitin të kryej mirëmbajtjen verore dhe dimërore. Kjo i ka kushtuar kosto shtesë komunës duke lidhur edhe një kontratë me një operator tjetër.

Më datën 19.02.2016 është paguar shuma 3,600€ në emër të shërbimeve të kryera nga Policia e Kosovës. Sipas listës së ofruar nga policia, ne nuk kemi gjetur se ku janë kryer këto shërbime.. Marrëveshja është lidhur më datën 15.07.2015 nga tre palët: komuna, policia dhe agjencia pyjore për një periudhë katër (4) mujore me çmim 2.5€/h, ku qëllimi i kësaj marrëveshje ishte parandalimi dhe mbrojtja nga asgjësimi i pyjeve. Sipas rishikimit analitik për vitin 2016 ishin paguar 21,120€ në emër të shërbimeve të kryera. Ne nuk kemi gjetur dokument tjetër për vazhdimin e kontratës.

Me rastin e testimit të pagesës prej 4,600€ në emër të eliminimit të qenve endacak, kemi vërejtur se Komuna nuk posedon dëshmi të mjaftueshme për formën e trajtimit të qenve të eliminuar. Ne kemi gjetur listën me numër prej 250 qenve të zënë, por jo edhe procesin nëse këta janë dërguar për trajtim të mëtutjeshëm apo janë eliminuar.

Rreziku Kontrollat e brendshme kanë dështuar të parandalojnë proceset e mësipërme të shoqëruara me parregullsi, të cilat mund t'i sjellin komunës kosto shtesë në përmbushjen e kontratave dhe aktiviteteve operative. Mungesa e raporteve me shkrim pa specifikuar punët e kryera, rrit rrezikun që punët të mos jenë kryer në pajtim me ofertën dhe kushtet e kontratës. Ndërsa pagesat pa kontratë, rrezikojnë që shpenzimet mos të arsyetohen, dhe si të tilla, mund të konsiderohen të parregullta.

Rekomandimi 13 Kryetari duhet të siguroj se menaxherët e projekteve përgatitin për çdo situacion raporte me shkrim duke specifikuar saktë rrugën apo lokacionin ku janë kryer punimet, si dhe të konfirmojnë sasinë dhe cilësinë e punëve. Po ashtu, duhet të siguroj as asnjë shpenzim nuk është certifikuar pa kontratë përkatëse.

Çështja 14 – Shpenzimet për shërbime komunale – Prioritet i mesëm

- E gjetura** Me datën 29.04.2016, ishte lidhur marrëveshja në mes Kryetarit të komunës dhe KRM "Pastërtia" nga Ferizaji për kryerjen e shërbimeve të kërkuara nga komuna e Kaçanikut. Me datën 24.11.2016 është paguar shuma prej 6,600€ në emër të shërbimeve lidhur me asgjësimin dhe groposjen e gjedheve të ngordhura. Sipas faturës ishin kryer shërbime për 60 sosh me çmim prej 110€ për copë. Në bazë të dokumentacionit të ofruar nuk kemi gjetur se në kuadër të marrëveshjes është cekur çmimi i faturuar prej 110€ për copë.
- Rreziku** Mungesa e dëshmive lidhur me çmimin për njësi mund të ketë si rrezik që çmimi i paguar në emër të shërbimeve të këtij lloji të mos jetë në harmoni me çmimin e tregut duke pasur parasysh se është lidhur marrëveshja e drejtpërdrejt me operatorin ekonomik.
- Rekomandimi 14** Kryetari duhet të siguroj se me rastin e çfarëdo marrëveshje të merret parasysh edhe kosto për shërbime dhe në rast se çmimi i ofruar nuk është i arsyeshëm të kërkoj shërbime nga ndonjë operator tjetër me kosto optimale shërbimi.

3.1.4 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 205,291€. Prej tyre ishin shpenzuar 204,270€. Shuma 157,354€ ishte shpenzuar për subvencione për entitete publike dhe jo publike, ndërsa shuma 46,916€ ishte shpenzuar si transfere mjeteve për përfitues individual.

Çështja 15 – Ndarja e subvencioneve – Prioritet i mesëm

- E gjetura** Te subvencionet e ndara për Klubin e Futbollit Lepenci, sipas pagesës së datës 27.09.2016 në vlerë 1000€ kemi vërejtur se mungojnë kërkesat e arsyetuara nga entitetet përfituese për shpenzimin e mjeteve financiare të përcaktuara sipas kriterëve të Rregullores së brendshme për ndarjen e Subvencioneve dhe Transfereve.
- Rreziku** Mos respektimi i kriterëve të nevojshme, të përcaktuara në Rregulloren e brendshme për subvencione dhe transfere, përkatësisht kriterit për përparshtrimin e kërkesave të kompletuara dhe të arsyetuara, për përfitimin e së drejtës për ndarjen e mjeteve financiare mund të rezultojnë me shpenzimin e mjeteve financiare nga përfituesit në mënyrë jo të drejtë sipas natyrës përkatëse.
- Rekomandimi 15** Kryetari duhet të sigurojë ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme për respektimin e kriterëve të përcaktuara në Rregulloren e brendshme, për sigurimin e kërkesave të mirë arsyetuara nga entitetet përfituese, me rastin e marrjes së vendimit për ndarjen e mjeteve financiare.
-

3.1.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 1,187,611€. Prej tyre ishin shpenzuar 1,014,508€. Komuna e Kaçanikut në vitin 2016 ka zhvilluar 97 aktivitete të prokurimit në vlerë prej 1,382,440€. Sipas listës së prokurimit komuna ka pasur edhe 13 aneks kontrata si punë shtesë në shumë prej 40,781€. Ne vijim do të prezantojmë të gjeturat të cilat kanë dalë nga rishikimi i dosjeve të prokurimit dhe pagesave.

Çështja 16 – Lidhja e kontratës për punë shtesë – Prioritet i lartë

E gjetura Me testimin e nëntë (9) mostrave nga investimet kapitale në shumë 539,923€, kemi gjetur se në pesë (5) raste ishin lidhur aneks kontrata për punë shtesë në shumë 10,935€. Aneks-kontratat nuk ishin lidhur për shkak të punëve të paparashikuara, por si rezultat i mos planifikimit të duhur dhe përgatitjes së paramasave dhe paralogarive.

Rreziku Mos përgatitja e duhur e paramasave dhe paralogarive për projektet e caktuara ka rezultuar me lidhjen e aneks kontratave për punë shtesë, e njëkohësisht edhe shpenzime shtesë për projektet kapitale.

Rekomandimi 16 Kryetari i Komunës duhet të sigurojë se paraprakisht janë rishikuar të gjitha paramasat dhe paralogaritë për projekte kapitale në mënyrë që realizimi i projekteve, sa herë që është e mundur, të bëhet vetëm me kontratën bazë.

Çështja 17 - Sigurimi i tenderit për afat më të shkurtër sesa afati i kontratës – Prioritet i lartë

E gjetura Tek kontrata për projektin “Ndërtimi i rrugës” në fshatin Biqec në vlerë 24,605€, kemi vërejtur se operatori ekonomik fitues nuk kishte sjellë sigurimin e tenderit sipas kërkesave të dosjes së tenderit. Kërkesa ishte që sigurimi i tenderit të bëhej për 90 ditë, ndërsa ishte paguar vetëm për 60 ditë.

Rreziku Mos respektimi i kriterëve të tenderit në këtë rast të sigurimit të tenderit e bën operatorin ekonomik të papërgjegjshëm dhe është mos respektim i LPP-së. Po ashtu, rreziku tjetër është mundësia e tërheqjes së OE para përfundimit të procedurave të prokurimit.

Rekomandimi 17 Kryetari duhet të sigurojë se gjatë çdo aktiviteti të prokurimit respektohet LPP dhe kriteret e caktuara në dosje të tenderit janë plotësuar nga OE pjesëmarrës.

Çështja 18 – Sigurimi i ekzekutimit – Prioritet i Lartë

E gjetura Me datën 18.03.2016 ishe lidhur kontratë për mirëmbajtjen dhe servisimin e automjeteve në shumën vjetore prej 11,750€. Sipas kriterëve të dosjes së tenderit fituesi do duhej të paguaj 10% nga vlera e kontratës në emër të sigurimit të ekzekutimit. Ne nuk kemi gjetur se ky kriter është plotësuar nga fituesi.

Rreziku Mungesa e sigurimit të ekzekutimit, rrite rrezikun e ekzekutimit të kontratës nga ana e operatorit ekonomik dhe pamundëson konfiskimin e sigurimit në rast të mos kryerjes së punëve.

Rekomandimi 18 Kryetari i komunës duhet të siguroj se zyra e prokurimit do t'i respektoj të gjitha kriteret e tenderimit dhe në rast të shkeljes apo mos zbatimit të kriterëve, të kërkoj përgjegjësi nga zyrtarët përkatësisht nga menaxheri i prokurimit.

Çështja 19 – Tejkalmi i korigjimit të vlerës së ofertës – Prioritet i mesëm

E gjetura Me datën 09.11.2016 është lidhur kontratë me operatorin ekonomik në shumë prej 8,227€, deri sa oferta e tij ishte 8,827€. Ne nuk kemi gjetur se komisioni për vlerësim të ofertave ka lënë gjurmë për korigjime të kësaj oferte. Për më tepër, vlera e kontratës ishte për 600€ më e ulët nga oferta financiare. Shkalla prej 7% ka tejkalar shkallën prej 2% të lejuar paraqet shkelje të rregullave të dala nga Ligji për Prokurim Publik.

Rreziku Komisioni për vlerësimin e ofertave nuk ka arritur të plotësoj kërkesat ligjore pasi që para lidhjes së kontratës do duhej të ri-llogarit vlerat e ofertës financiare. Ky fakt ka bërë që të lidhet kontratë me operatorin ekonomik si ofertues i papërgjegjshëm. Prandaj, mos respektimi i kërkesave të dala nga Ligji i prokurimit Publik mund të ketë si rezultat lidhjen e ofertës të pakontrolluar dhe jo të korigjuar në kohën e duhur dhe jo transparencë karshi ofertuesve tjerë.

Rekomandimi 19 Kryetari i komunës duhet të siguroj se zyra e prokurimit, përkatësisht komisioni për vlerësim të ofertave do t'i respektoj të gjitha kriteret e dosjes së tenderit si dhe kërkesat tjera ligjore dhe në rast të shkeljes apo mos zbatimit të kriterëve, të kërkoj përgjegjësi nga zyrtarët, përkatësisht nga menaxheri i prokurimit.

Çështja 20 – Bashkëfinancimet dhe pagesat tjera – Prioritet i lartë

Në vitin 2016, Komuna kishte paguar shumën 97,428€ në llogari të OJQ “Kosova Luxemburg” si bashkë financues në tri projektet e fituara, për: (1) Zhvillimi i komuniteteve, (2) Mbështetje për bizneset fillestare dhe ekzistuese, dhe (3) Zhvendosja e personelit të QKMF. Ne kemi testuar të gjitha pagesat dhe në kuadër të pagesave kemi gjetur se shuma prej 25,000€ e paguar në llogari të donatorit ishte bërë në bazë të një aneksi për ndërtimin e kulmit të shkollës në fshatin Stagovë, deri sa nuk kemi gjetur të bashkëngjitur paramasën dhe parallogarinë e projektit. Shuma tjetër prej 25,728€ ishte bërë në emër të projektit për asistencë bizneseve fillestare dhe ekzistuese. Pagesa tjera ishin bërë për donatorin sipas projektit “Zhvillimi i komuniteteve” duke prezentuar raport për ndihmë me mjedra për 15 përfitues dhe sistem pikësh për 16 përfitues të tjerë. Komuna ka paguar dhe regjistruar gabimisht si avance për investime, ndërsa këto pagesa i takojnë kategorisë për subvencione dhe transfere dhe jo kategorisë për investime kapitale. Raste të tilla të pagesave nga kategoria për investime kapitale janë gjetur në të gjitha pagesat tjera të përfshira në shumën totale prej 97,428€.

Rreziku Pagesa e shpenzimeve për subvencione dhe transfere nga kategoria e investimeve kapitale, mund të ketë ndikim negativ në plotësinë, cilësinë dhe saktësinë e raporteve financiare të ofruara. Pagesat, si të tilla, janë të klasifikuara gabim dhe mund të rezultojnë me theksim të çështjes.

Rekomandimi 20 Kryetari duhet të përmirësoj procesin e planifikimit dhe të sigurojë monitorim të këtyre marrëveshjeve që nga inicimi deri në realizimin e plotë të tyre për të parandaluar pagesat për subvencione dhe transfere nga buxheti për investime kapitale.

3.2 Pasuritë

3.2.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Gjatë vitit 2016 Komuna ka bërë një progres të dukshëm në aspektin e regjistrimit të pasurive në krahasim me vitin paraprak. Përkundër progresit, ende nuk është arritur që regjistri kontabël i pasurive të jetë i saktë. Mos regjistrimi i pasurisë kapitale sipas kategorisë përkatëse është trajtuar tek pjesa e Theksimit të Çështjes në Opinion, ndërsa në vijim do të paraqiten disa çështje tjera, të cilat komuna do duhej t'i merrte parasysh në vitin 2017.

Çështja 21 - Përdorimi i E-pasurisë jo në mënyrë funksionale - Prioritet i lartë

E gjetura Komuna e Kaçanikut e përdorë softuerin “e-Pasuria” për t'i regjistruar pasuritë jo financiare nën 1,000€ dhe stoqet. Sipas zyrtarit ky sistem nuk është mjaft funksional për shkak të mos përllogaritjes së zhvlerësimit.

Rreziku Mos funksionalizimi i sistemit e-pasuria duke pasur parasysh edhe përllogaritjen e zhvlerësimit për pasuritë nën 1,000€ kanë si rezultat që shumica e prezentuar në raportin financiar vjetor të mos jetë e saktë dhe nuk i ndihmon menaxhmenit në planifikimin për blerjet e pajisjeve në kohën e duhur.

Rekomandimi 21 Kryetari duhet të sigurojë se e-pasuria do të funksionoj në kapacitete të plota, dhe me rastin e planifikimit të buxhetit të merren informata të sakta për pajisjet e amortizuara, në mënyrë që të mundësohet zëvendësimi i tyre në kohën e duhur duke shmangur problemet me aktivitetet operative të komunës.

3.2.2 Trajtimi i parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj

Çështja 22 - Depozita në bankë - Prioritet i lartë

E gjetura Sipas rregullave financiare, të gjitha mjetet deri në 10€ mund të mblidhen nga komuna në të gatshme. Mirëpo, në fund të ditës ato duhet të derdhen në bankë së bashku me dokumentin përmbledhës të përcaktuar si numër identifikues me UNIREF. Testimi i depozitës së mjeteve prej 1,942€ është bërë me 21.03.2016 deri sa këto mjete janë mbledhur prej datës 14.03 - 18.03.2016. Kjo praktikë është e zakonshme në komunën e Kaçanikut.

Rreziku Moszbatimi i rregullave të Thesarit për depozitimin e parasë publike në fund të ditës ka si rrezik që mbajtja e parasë për disa ditë me radhë, të keqpërdoret apo të manipulohet.

Rekomandimi 22 Kryetari duhet të sigurojë se një praktikë e tillë do të ndërpritet, dhe të zbatohen kërkesat e rregulloreve financiare që të gjitha shumatat e mbledhura në kesh, të depozitohen në bankë brenda afateve ligjore të përcaktuara.

3.2.3 Te arkëtueshmet

Llogaritë e arkëtueshme të komunës prezantojnë shuma të mjeteve që qytetarët dhe organizatat i detyrohen komunës për shërbimet, punët, mallrat apo pronat që i kanë përfituar nga komuna. Sipas shënimeve të prezantuara në PFV shuma totale e këtyre llogarive në fund të vitit 2016 ishte 1,289,500€.

Çështja 23 – Rritja e vazhdueshme e borxheve të pa mbledhura - Prioritet i lartë

E gjetura

Edhe pse të hyrat nga tatimi në pronë përbëjnë pjesën më të madhe të të hyrave vetjake, ato në fund të vitit 2016 kanë rezultuar me një borxh të pa arkëtuar prej 1,002,540€. Rast tjetër me rëndësi, ishte edhe me borxhet nga taksa në firmë ku në fund të vitit 2016 ishin të pa arkëtuara 204,280€, ndërsa ato të qirasë për shfrytëzimin e pronës komunale ishin 82,860€. Këto tre lloje ishin prezentuar si llogari të arkëtueshme në fund të vitit. Ne nuk kemi vërejtur se komuna ka ndonjë strategji konkrete për inkasimin/zvogëlimin e të arektueshmeve.

Për vitin 2016 komuna ka ngarkuar taksën në firmë për biznese në shumë 42,850€, deri sa të hyrat e inkasuara për vitin 2016 ishin 23,844€ apo 56% nga plani. Evidenca e mbajtur nga zyrtari përgjegjës përmban vetëm ngarkesën vjetore deri sa kjo evidencë nuk përmban edhe saldon nga viti paraprak. Sipas raportit financiar në fund të vitit 2016 kishin mbetur si llogari të arkëtueshme shuma prej 204,290€. Ne nuk ishim në gjendje të verifikojmë këtë shumë për shkak të evidencës së mangët të mbajtur nga zyrtari përgjegjës. Për më tepër, komuna kishte marrë disa veprime të kufizuara, por nuk ka ndonjë strategji gjithëpërfshirëse për inkasimin e këtyre të arkëtueshmeve.

Rasti tjetër, ishte edhe me lokale të cilat komuna me një vendim të Kuvendit të datës 03.05.2012 kishte rrënuar rreth 26 lokale të vjetra me qëllim të ndërtimit të parkut të qytetit. Shuma e pa arkëtuar nga qiramarrësit në fund të vitit 2016 ishte 33,325€. Komuna nuk ka analizuar dhe shqyrtuar mundësinë e inkasimit të kësaj shume nga qiramarrësit.

Komuna kishte ndërmarrë disa veprime ndaj shfrytëzuesve të pronës komunale duke ju dërguar shkresa/vërejtje për t'i kryer obligimet dhe kjo ka pasur efekte deri në një masë. Te hyrat nga qiraja ngelin edhe më tutje sfidë dhe nevojiten angazhime shtesë nga menxhementi i komunës.

Rreziku

Mungesa e një evidence të mirëfilltë të taksës në biznes, e bën të vështirë të krahasohet sipas viteve gjendjen e llogarive të arkëtueshme e prezentuar në raportin financiar vjetor. Mungesa e strategjisë nga viti në vit, ka bërë që shuma e pa arkëtuar nga qiraja të akumulohet dhe rrënimi i lokaleve mund të ndikoj që qiramarrësit të mos paguajnë borxhet ndaj komunës, dhe borxhet të mbesin të pambledhshme.

Rekomandimi 23 Kryetari duhet të siguroj se evidencat për të gjithë tatimpaguesit do të azhurnohen dhe të kompletohen me të gjitha informatat e nevojshme dhe të analizoj shkaqet për inkasim të ulët, si dhe të krijoj mekanizma për rritjen e inkasimit. Po ashtu, të gjej zgjidhje praktike për borxhet e mbetura nga qiramarrësit e lokaleve të rrënuara.

3.3 Obligimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnizuesve në fund të vitit 2016 ishte 126,590€, deri sa në vitin 2015 ishin 69,400€. Pra, vërehet një rritje prej 57,190€. Po ashtu, në fund të vitit janë prezantuar detyrimet kontingjente si konteste gjyqësore në shumë 279,450€ deri sa në vitin paraprak ishin 194,980€. Sipas analizës së llogarive të pagueshme, kemi vërejtur se komuna në vitin 2016, ka paguar gjithsej 126,590€ fatura të papaguara të vitit 2015.

Çështja 24 - Menaxhim i dobët i detyrimeve - Prioritet i lartë

E gjetura Sipas një analize, del se komuna në vitin 2016, ka paguar fatura të vitit 2015 në shumë prej 126,590€, deri sa faturat e papaguara të prezantuara në fund të vitit 2015 ishin 69,400€. Sipas kësaj analize del se komuna nuk ka prezantuar drejt obligimet e saj duke shkaktuar nënvlerësimin e tyre prej 57,190€;

Komuna nuk kishte pasur një plan të mirëfilltë të rrjedhës së parasë për pagesën e obligimeve të ndodhura. Në fund të vitit 2016 ishin regjistruar obligime nga kategoria subvencione dhe transfere në shumë 14,150€ deri sa shuma e mbetur e buxhetit për këtë kategori ishte 1,021€. Pra, është tejkaluar buxheti për këtë kategori në shumë prej 13,129€. Si çështje për vëmendje do të mbetet në auditimin e radhës për të rishikuar nëse ka fatura të paguara dhe të pa prezentuara nga komuna.

Rreziku Komuna nuk ka prezentuar drejt dhe saktë obligimet e vitit paraprake dhe si rezultat i kësaj ka nënvlerësuar obligimet e saj. Po ashtu, hyrja në obligime përtej ndarjeve buxhetore, veçanërisht për subvencione dhe transfere, mund të ketë si rrezik që një pjesë e buxhetit të vitit aktual të shpenzohet për obligimet e mbetura nga viti i kaluar.

Rekomandimi 24 Kryetari duhet të siguroj se ekziston një raportim i drejtë dhe në kohë i të gjitha faturave të papaguara nga të gjitha departamentet, si dhe duhet të siguroj se planifikimi i buxhetit bëhet në bazë të një plani të qartë të rrjedhës së parasë, duke mos tejkaluar në asnjë rast ndarjet buxhetore.

Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.2 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinionin e auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçe për të cilat Kryetari duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuara të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë - Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët i janë raportuar veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keq deklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keq deklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
1.5 Rekomandimet	Prioritet i lartë - Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që është bërë një analizë për të përcaktuar arsyet për kualifikimin e opinionit të auditimit dhe paragrafin e theksimit të çështjes. Veprimi duhet ndërmarrë për të adresuar dobësitë e rëndësishme në një mënyrë sistematike dhe pragmatike për të zbutur dobësitë e shpalosura në paragrafin e bazës për opinion të kualifikuar.	Po është zbatuar ky rekomandim.		
	Prioritet i lartë - Kryetari duhet të marrë masat e duhura për të siguruar pajtueshmëri rregullative të plotë të procesit të përgatitjes së pasqyrave vjetore financiare (PVF). Deklarata e bërë nga Kryetari i Komunës dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PVF-të të dorëzohen në Qeveri duhet të nënshkruhet vetëm pas një shqyrtimi gjithëpërfshirës të menaxhmentit i ndërmarrë në përmbajtjen dhe saktësinë e PVF..	Po është zbatuar ky rekomandim.		
2.3 Rekomandimet e vitit paraprak	Kryetari i komunës duhet të rishikoj Planin e Veprimit për adresimin e rekomandimeve të vitit 2014 dhe atyre më herët. Ky plan duhet të përcaktojë një kornizë të arsyeshme kohore të zbatimit, personel përgjegjës dhe modalitet në aplikim, duke u fokusuar fillimisht në fushat e rëndësisë së lartë, aty ku janë identifikuar dobësi domethënëse. Progresi i planit duhet të monitorohet direkt nga Kryetari i Komunës.	Po është zbatuar ky rekomandim.		

2.4 Lista kontrolluese e vetëvlerësimit nga MF	Kryetari duhet të sigurojë që lista kontrolluese e vetëvlerësimit është plotësuar me objektivitet dhe është dokumentuar për të identifikuar dobësitë dhe për ti zvogëluar ato në mënyrë të përshtatshme, siç kërkohet nga Ministria e Financave e Republikës së Kosovës.		Pjesërisht është zbatuar ky rekomandim, pasi nuk ishte bërë hartimi i listës së rreziqeve.	
2.5.1 Aranzhimet e llogaridhënies	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë një rishikim të kërkesave ekzistuese të llogaridhënies dhe raportimit të drejtorive komunale për të siguruar angazhime të përmirësuara për të arritur objektivat e veçanta gjatë një viti.		Pjesërisht është zbatuar ky rekomandim, pasi raportimi nuk ishte i plotë për të konstatuar menaxhmenti se objektivat janë arritur në kohën e duhur.	
2.5.2 Menaxhimi i riskut	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që procedurat dhe sistemet e menaxhimit të riskut janë krijuar dhe janë funksionale. Për më tepër, përgjegjësia për menaxhimin e riskut është deleguar direkt në një drejtori përkatëse që të sigurojë raportimin mujor mbi zbatimin e kërkesave në këtë fushë dhe të sigurojë se risqet duke u menaxhuar.		Pjesërisht është zbatuar ky rekomandim, por mungesa e qasjes së rreziqeve ende ka mbetur të zbatohet në të ardhmen.	
2.5.3 Raportimi Menaxherial	Kryetari i Komunës duhet të rishikojë masat ekzistuese të qeverisjes së përgjithshme dhe cilësinë e raportimit të brendshëm të Komunës. Kërkesat pazbatuara duhet të adresohen deri në fund të vitit 2016. Cilësia e raportimit dhe mbikëqyrjes buxhetore duhet të shqyrtohet në mënyrë kritike dhe sistematike për të siguruar arritjen e objektivave të Komunës.		Pjesërisht është zbatuar ky rekomandim, pasi ka vend që raportimi nga drejtoritë të bëhet edhe me cilësore.	
2.6 Sistemi i auditimit të brendshëm	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që Departamenti i Auditimit të Brendshëm ka burime të përshtatshme dhe të mjaftueshme njerëzore. Për më		Pjesërisht është zbatuar ky rekomandim, pasi duhet të monitorohet	

	teper, Kryetari duhet të sigurojë që aktiviteti i ardhshëm i AB duhet të udhëhiqet në drejtim të zhvillimit dhe zbatimit të strategjisë së auditimit të bazuar në risk. Gjithashtu, në mënyrë që përfitimet të jenë të dukshme, Kryetari duhet të marrë masa për zbatimin e rekomandimeve të AB brenda Komunës.		edhe implementimi i rekomandimeve të NJAB.	
3.4 Prokurimi	Kryetari duhet të identifikoj shkaqet rrënjësore të mangësive dhe të ndërmarrë masat e duhura për të siguruar se kërkesat e ligjit të prokurimit janë zbatuar plotësisht.	Po është zbatuar ky rekomandim.		
3.5 Shpenzimet jo përmes prokurimit	Kryetari duhet të sigurojë që Komuna të ndërmarrë hapa të mëtutjeshme për përmirësimin e kontrolleve mbi shpenzimet dhe pagesat që ato të jenë në pajtueshmëri me ligjet dhe rregulloret përkatëse			Jo nuk është zbatuar pasi nuk janë ndërmarrë masa për pagesat e tilla të bëhen në pajtim me ligjet dhe Rregulloret përkatëse.
3.5.2 Kompensimet (Pagat dhe Mëditjet)	Kryetari duhet të sigurojë që Komuna të ndërmarrë hapa të mëtutjeshëm për përmirësimin e kontrolleve mbi dosjet e personelit në mënyrë që dosjet të jenë të kompletuara dhe organizuara mirë dhe të marrë masa në lidhje me nënshkrimin e listës së pagave.		Pjesërisht është zbatuar ky rekomandim. Disa nga dosjet ende ishin të pakompletuara të cilat sipas atyre do të kompletohen në vitin 2017.	
3.6 Të hyrat (përfshirë të hyrat vetanake)	Ne rekomandojmë Kryetarin të ndërmarrë këta hapa: Të ndërmarr hapa për të përmirësuar sistemin e faturimit, dhe të kontabilitetit në mënyrë që të sigurojë kontrolle eficientë dhe efektive në faturim, dhe në të hyra. Përmirësimi i procedurave lidhur me	Po është zbatuar ky rekomandim.		


	<p>sisteme të tilla do të mundësonte menaxhmentin të monitoroj dhe të menaxhoj risqet e mëdha, dhe të siguroj që vendimet lidhur me buxhetimin, planifikimin dhe arkëtimin e të hyrave bëhen në mënyrë të duhur.</p> <p>Të sigurohet që anketimet dhe kushtëzimi i provizionimit të shërbimeve bëhet siç kërkohet me Udhëzimin Administrativ Nr. 03/2011 dhe Nr. 07/2011.</p>			
3.7 Pasuritë dhe detyrimet	<p>Kryetari duhet të sigurojë regjistrimin në kohë dhe të saktë të të gjitha pasurive në regjistrat përkatës, në përputhje me kërkesat e rregullores 02/2013.</p> <p>Gjithashtu duhet të sigurojë që pasuritë kapitale të cilat regjistrohen përmbajnë informacion të plotë, duke përfshirë datën kur pasuria është vënë në përdorim, në mënyrë që llogaritja e zhvlerësimit të mund të kryhet me saktësi, si dhe të përcaktojë statusin e pronësisë.</p>			Jo nuk është zbatuar ky rekomandim, pasi nuk janë bërë veprime konkrete për plotësimin e regjistrit të pasurive me të gjitha informatat e nevojshme.
	<p>Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që inventarizimi i pasurive kapitale jo-financiare është kryer në pajtim me Rregulloren në fuqi për pasuritë jo-financiare të Organizatave Buxhetore dhe për të siguruar se inventarizimi bëhet në baza vjetore.</p>			Jo nuk është zbatuar ky rekomandim pasi nuk ka pasur veprim konkret për inventarizimin e pasurive.
	<p>Rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të siguroj se Komuna është duke bërë përpjekje maksimale për sigurimin e të dhënave nga palët e treta, me theks të veçantë në ato palë që dihet se kanë kryer investime të rëndësishme në komunë. Të dhënat e marra duhet</p>			Jo nuk është zbatuar ky rekomandim. Nuk ishin marrë masa lidhur me

	të paraqiten si duhet në regjistrin e pasurive të Komunës. Praktika më e mirë do të kërkojë një barazim vjetor bazë të të dhënave në mes të palëve të treta dhe Komunës për investime në Komunën për vitin përkatës.			mbledhjen e informatave për pagesat nga palët e treta.
3.7.2 Trajtimi i parasë së gatshme(dhe ekuivalentëve të parasë së gatshme)	Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurohet se depozitat e përditshme të parasë dhe kontrollet janë kryer ashtu siç kërkohet nga legjislacioni në fuqi.			Jo nuk është zbatuar ky rekomandim pasi nuk ka pasur veprim konkret.
3.7.3 Trajtimi i të arkëtueshmeve	Kryetari i Komunës duhet të sigurohet se Komuna ndërmerr hapa dhe të hartoj një plan të detajuar lidhur më arkëtimin e borxheve të vjetra.		Pjesërisht është zbatuar ky rekomandim, pasi që vetëm disa vërejtje me shkrim janë bërë.	
3.7.4 Trajtimi i borxheve	Kryetari duhet të sigurojë që Komuna do të ndërmarrë hapa të mëtutjeshëm dhe të zhvilloj plane veprimi për të bërë pagesat brenda periudhës së kërkuar.			Jo nuk është zbatuar ky rekomandim.
Gjithsej	18	5	7	6

Shtojca IV: Letër konfirmimi



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik



Data	12.05.17	Vendi	KAÇANIK
Nj. org.		Nupri	
	01		17-03-15801-1

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2016 dhe për implementimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Kaçanik, 12.05.2017

I nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për Auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Kaçanikut , për vitin 2016 (në tekstin e mëtejshëm "Raport");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

për Kryetari: BOSIM ILIĆ

